


# Shkaqet e Vdekjeve

**Tiranë, më 22 Maj 2018:** Në vitin 2017, numri i vdekjeve të regjistruara në Shqipëri është 22.232, duke shënuar një rritje prej 3,9 %, krahasuar me vitin paraardhës. Sipas gjinisë, numri i vdekjeve të raportuara për meshkujt është 11.610 (2,9 % më shumë se në vitin 2016) dhe për femrat 10.622 (5,1 % më shumë se në 2016).

Koeficienti bruto i vdekshmërisë për vitin 2017 është 77,4 vdekje për 10 mijë banorë, përkundrejt 74,4 që ishte në vitin 2016.

Referuar shkaqeve të vdekjeve, peshën më të madhe e zënë vdekjet nga “Shkaqet natyrale” 90,1%, ndjekur nga “Aksidentet” me 2,1 %.

**Fig. 1 Vdekjet sipas shkaqeve kryesore, 2017**



*\*të panjohura janë rastet që nuk e kanë të përcaktuar shkakun*

Në vitin 2017, vdekjet nga grupsëmundja “Aparati i qarkullimit të gjakut”, përbëjnë 53,7 % të vdekjeve gjithsej. Ky grup-sëmundjesh vazhdon të jetë shkaku kryesor i vdekjeve, me një nivel vdekshmërie 41,5 për 10 mijë banorë, duke shënuar një rritje prej 2,5 %, krahasuar me vitin paraardhës. Brenda këtij grupi, përqindjen më të lartë e zë vdekshmëria nga “Sëmundje të enëve të trurit” me 32,6 % dhe “Sëmundje kronike të zemrës” me 26,3 %.

Vdekjet nga grupsëmundja “Tumore” zënë 16,4 % të vdekjeve gjithsej, duke u renditur si grupi i dytë kryesor referuar numrit të vdekjeve të shkaktuara. Niveli i vdekshmërisë për këtë grup-sëmundje është 12,7 për 10 mijë banorë dhe ka një rritje prej 2,0 %, krahasuar me vitin 2016. Në grupin “Tumore” përqindjen më të lartë e zë nëngrupi “Tumore të aparatit të frymëmarrjes”, me 33,5 %.

**Për publikim 22/05/2018**

Vdekjet nga grupsëmundja “Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë”, renditet si grupi i tretë kryesor referuar numrit të vdekjeve të shkaktuara. Niveli i vdekshmërisë për këtë grupsëmundje është 16,0 %, duke shënuar një rritje prej 11,2 %, krahasuar me vitin 2016. Në këtë grup, 75,5 % e zënë vdekjet në moshën 80 vjeç e lart dhe shkaku specifik i vdekjes është “Vdekje nga pleqëria”.

**Tab. 1 Shkaqet kryesore të vdekjeve sipas grupsëmundjeve, 2017 (Klasifikimi ICD 9\*)**


	2016	2017	Ndryshimi në % për çdo sëmundje
Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut	11637	11926	2,5
Tumore	3571	3645	2,1
Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë	3206	3566	11,2
Dëmtime traumatike dhe helmime	892	820	-8,1
Sëmundje të aparatit të frymëmarrjes	554	656	18,4
Sëmundje të sistemit nervor qendror dhe të organeve të shqisave	298	346	16,1
Sëmundje të aparatit të tretjes	296	316	6,8
Sëmundje endokrine të të ushqyerit	294	308	4,8
Sëmundje të organeve urogenitale	253	248	-2,0
Sëmundje mendore	101	100	-1,0
Sëmundje që shfaqen në periudhën rreth lindjes	76	97	27,6
Ndërlikime në barrë, të lindjes dhe të periudhës së paslindjes	75	61	-18,7
Sëmundje të gjakut dhe të organeve formuese të gjakut	41	43	4,9
Sëmundje infektive e parazitare	40	37	-7,5
Sëmundje të sistemit të kockave dhe të kyçeve	26	37	42,3
Anomali të bashkëlindura	20	24	20,0
Sëmundje të lëkurës dhe të indit qelizor në lëkurë	8	2	-75,0
	21388	22232	3,9

\*Klasifikimi ndërkombëtar i sëmundjeve

### Vdekshmëria sipas gjinisë

Grupi i sëmundjeve të “Aparatit të qarkullimit të gjakut” janë shkaku kryesor i vdekjeve si tek femrat ashtu edhe tek meshkujt, përkatësisht 210 dhe 205 për 100 mijë banorë. “Tumoret” janë shkaku i dytë kryesor i vdekjeve për të dyja gjinitë, me një dominancë tek meshkujt, prej rreth 30 pikë përqindje. Niveli i vdekshmërisë për këtë grupsëmundje shënon vlerën 78,3 për meshkujt dhe 48,5 për femrat për 100 mijë banorë.


**Fig. 2 Koefficienti bruto i vdekshmërisë sipas grup-sëmundjeve dhe gjinisë (për 100 mijë banorë)**



**Vdekshmëria sipas grupmoshës**

Në vitin 2017, niveli i vdekshmërisë foshnjore është 8,03 për 1000 lindje të gjalla, kundrejt 8,7 shënuar në vitin 2016. Shkaqet kryesore të vdekshmërisë foshnjore (nën 1 vjeç) janë “Sëmundjet që shfaqen në periudhën e rreth-lindjes” me 39,1 % dhe “Ndërlikime në barrë, të lindjes dhe të periudhës së paslindjes” me 24,8 % të vdekjeve të kësaj grupmoshe.

**Fig. 3 Vdekshmëria foshnjore sipas shkaqeve kryesore (%)**




Në grupmoshën 1-14 vjeç, ndër 4 grupsëmundjet kryesore peshën më të lartë e zë “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut” me 48,0 % të numrit të vdekjeve për këtë grupmoshë.

Në grupmoshën 15-39 vjeç, peshën më të lartë e zë “Dëmtime traumatike dhe helmime”, me mbi 45 % të numrit të vdekjeve për këtë grupmoshë.

Në grupmoshën 40-49 vjeç, peshën më të lartë e zë “Tumore”, me 38,6 % të numrit të vdekjeve për këtë grupmoshë.

Në grupmoshat 50 deri 80 e më shumë vjeç, pjesën më të madhe të vdekjeve e shkakton grup-sëmundja “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut”.

**Fig. 4 Pesha specifike që zënë grup-sëmundjet kryesore për çdo grupmoshë (%)**




**Vdekshmëria sipas qarqeve**

Grupsëmundja “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut” është shkak dominant i vdekjeve në të gjitha qarqet. Ky shkak shënon vlerën më të lartë në qarkun e Beratit me 61,7 % të numrit gjithsej të vdekjeve dhe të Kukësit me 61,6 % të numrit gjithsej të vdekjeve.

Grupsëmundja “Tumore”, shkakton mbi 13,0 % të vdekjeve gjithsej në secilin qark, duke shënuar vlerën më të lartë në Shkodër me 18,2 % të vdekjeve.

Grupsëmundja “Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë” është shkak i tretë kryesor i vdekjeve për të gjithë qarqet, me vlerën më të lartë në qarkun e Elbasanit me 24,3 % dhe Gjirokastrës me 21,4 %.

Fig. 5 Vdekshmëria sipas grupsëmundjeve dhe qarqeve



# Metodologjia

**Shkaku i vdekjes** është sëmundja ose simptoma që ka shkaktuar ose kontribuar në vdekje, si dhe rrethanat e aksidentit që kanë shkaktuar këto trauma (Përshkruhet në certifikatën e vdekjes). Burimi i të dhënave është Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

**Klasifikimi Ndërkombëtar "ICD-9"** është klasifikimi ndërkombëtar i shkaqeve të vdekjes, që bën grupimin në mënyrë të koduar të 17 grupeve kryesore të sëmundjesh. Ky kodim bëhet nga mjeku dhe përbën burimin më të plotë zyrtar statistikor të sëmundjeve që janë shkak i vdekjes.

**Sëmundshmëria** është frekuenca e sëmundjeve në një popullsi. Ajo matet me: Prevalencën që është numri i të gjitha rasteve të sëmundjeve në një popullsi, në një moment të dhënë (frekuenca e çastit), ose gjatë një periudhe të dhënë, pa dallim nëse sëmundja është në fillim ose jo dhe pa dallim ndërmjet rasteve të reja apo të vjetra.

**Vdekja** nënkupton zhdukjen e qëndrueshme të të gjitha shenjave të jetës në një moment të çfarëdoshëm pas një lindjeje të gjallë (ndërprerjen e funksioneve jetësore pa mundësi reanimimi). Ky përkufizim nuk përmban vdekjen fetale.

**Vdekshmëria** shpreh vdekjet si një komponent i ndryshimit të popullsisë, e cila i ndodh çdo pjestari të popullsisë.